



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga “MIGJENI” (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

Psh. nr. 0354/2026

Duke u bazuar në nenin 98 paragrafi 2, nenit 108/A dhe 109 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05, L-068, si dhe Ligjin 05/ L-002, si nenin 50 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Ligji nr. 05/L-031, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i Stacionit Policor Veri në Prishtinë” me numër të prokurimit 214/30400-26-1946-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Policia e Kosovës, Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit të OSHP-së, Ardian Behra, me datë: 08.06.2026, mori këtë:

KONKLuzion PËR PËRMISIM VEndIMI

Përmisohet, vendimi me nr. të protokollit: Psh.nr. 0354/2026, i dt. 08.06.2026, pasi që vendim janë lëshuar gabime teknike nga zyra ligjore gjatë hartimit të arsyetimit të vendimit, me saktësisht vendimi korrigjohet dhe ankesa trajtohet si e jashtë afatshme për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Stacionit Policor Veri në Prishtinë” me numër të prokurimit 214/30400-26-1946-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Policia e Kosovës

Arsyetim

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së Ardian Behra, me datën 08.06.2026 ka marrë vendimin me numër të protokollit Psh.nr. 0354/2026.

Gjatë hartimit të vendimit është ngatërruar numri i lëndës nga zyra ligjore duke u lëshuar gabim në arsyetim të vendimit e cila është veretur menjëherë, andaj vendimi duhet të korrigjohet në këtë mënyrë:

Hedhet si jashtëafatshme, ankesa e OE “Astraplan SH.P.K me nr. të protokollit 0354/2026, e datës 02.06.2026, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimi i Stacionit Policor Veri në Prishtinë” me numër të prokurimit 214/30400-26-1946-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Policia e Kosovës, në cilësi të AK-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 02.06.2026, ka pranuar ankesën e OE “Astraplan SH.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i Stacionit Policor Veri në Prishtinë” me numër të prokurimit 214/30400-26-1946-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Policia e Kosovës në cilësinë e Autoriteti Kontraktues.

Me 10.04.2026, Policia e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë ku hapja e ofertave e parashikuar me B05 ka qenë e planifikuar të bëhet më datën 02.06.2026.

Operatori Ekonomik “Astraplan SH.P.K, me datën 02.06.2026 ka parashtruar ankesë në OSHP me numër të protokollit 2026/0354.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit si në dispozitiv të këtij vendimi, me datën me 10.04.2026, është publikuar njoftimi për kontratë ku hapja e ofertave e parashikuar me B05 ka qenë e planifikuar të bëhet më datën 02.06.2026.

OE “Astraplan SH.P.K ka parashtruar drejtpërsëdrejti Ankesë në OSHP me dt. 02/06/2026 (20:34) që i bie të bartët për dt. 03/06/2026. Ankesa është parashtruar në kundërshtim me nenin 109 paragrafi 2 të LPP-së sepse është parashtruar jashtë afatit prej 10 ditësh ku thuhet: 2. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

Po ashtu Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas të gjitha fakteve të analizuar sqaron se sipas nenit 111 paragrafi 1. 10 të Ligjit për Prokurim Publik çdo palë e interesuar mund të dorëzojë një ankesë në OSHP nëse ankesa e tillë ka dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit, të përmendur në nenin 118 të këtij ligji.

Poashtu sipas nenit 118 paragrafi 1 dhe 2 i LPP-së thuhet: “1. Ankuesit duhet të paguajnë një tarifë të ankesave në OSHP vlera e së cilës do të përcaktohet nga KRPP-ja në legjislacionin dytësor. Dëshmia e pagesës duhet ti bashkëngjitet vetë ankesës në përputhje me nenin 111 të këtij ligji. Pagesa do të bëhet në para të gatshme ose në ekuivalent të parave të gatshme në një llogari të hapur nga OSHP-ja në përputhje me Rregullat Financiare. 2. OSHP nuk do të pranojë ankesën nëse tarifa nuk paguhet”.

Kryesuesi i Sekretariatit, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala

e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës

Kompetente në afat prej 30 ditësh nga data e pranimin të këtij vendimi.

Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së



Ardian Behra

Të njoftohen palët:

1x1 AK

1x1 OE ankues

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.